

Vlore me, 19.10.2020

FTESË PËR SHPREHJE INTERESI

**ME OBJEKT: OFRIM TË KURSEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL
PËR PËRFITUES TË PROJEKTIT YEEP**

Informacion i përgjithshëm rreth QSHPZH:

QSHPZH-ja është një organizatë jo fitimprurëse, e themeluar në Janar të vitit 1993, e cila punon për përmirësimin e politikave, legjislacionit, të drejtën për informacion dhe shërbime për çështje që shqetësojnë popullatën dhe zhvillimin e saj, përfshirë shëndetin riprodhues.

Organizata duke qënë implemetuese e projektit: *“Rritja e mundësive për integrim në tregun e punës të të rinjve dhe familjeve në vështirësi ekonomike, “Increasing opportunities for labor market integration of youth and families at risk – YEEP Vlora ”*, i cili zbatohet nga Qendra Aulona Vlore si dege e Qendra Shqiptare per Popullsin dhe Zhvillimin dhe financohet nga Ministria Federale Gjermane per Bashkepunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe SOS Fshatrat e Femijeve Shqiperi, hap thirrjen për blerjen e produkteve dhe shërbimeve.

Qëllimi i kësaj Ftese për Shprehjen e Interesit është të identifikojë ofruesit e kualifikuar për kurse dhe trajnime të formimit profesional të cilësuar më poshtë. Këto kurse dhe trajnime kërkohen për te mbështetur të rinjtë përfitues të projektit: *“Rritja e mundësive për integrim në tregun e punës të të rinjve dhe familjeve në vështirësi ekonomike- YEEP”* i cili zbatohet nga Qendra Shqiptare per Popullsin dhe Zhvillimin, dega e saj Qendra Aulona Vlore, shpall këtë ftesë publike për Shprehje të Interesit për Ofrues të Kurseve / Trajnimeve të Formimit Profesional në fushat e mëposhtme:

Nr	Emërtimi i Kursit	Kohëzgjatja e Kursit dhe Sesionet	Cmimi ne lek me TVSH
1	Parukeri, Berber, Kozmetikë dhe estetikë, Manikyr dhe pedikyr		
2	Kuzhinier (nivele I dhe II), Pasticier etj		
3	Hoteleri -Turizëm		
4	Elektriçist / instalime elektrike		
5	Rrobaqepës / niveli fillestar dhe niveli i avancuar		
6	Hidraulik		
7	Saldator		
8	Riparues makina qepëse/tekstili		

9	Instalues dhe Riparues të Panele Diellore dhe Fotovoltaike		
10	Mekanik Automjetesh		
11	Licencë për Drejtim Automjetesh Klasi B		
12	Elektroaut (nivele I dhe II)		
13	Instalues dhe Riparues të Kondicionerëve të automjeteve		
14	Instalues dhe Riparues të Kondicionerëve shtëpiake		
15	Riparues të Paisjeve Elektronike		
16	Java (gjuhë programimi)		
17	Kurs për sekretari		
18	Kurse në fushën e informatikës		
19	Kurse për ekonomist kontabël		
20	Web & graphic design		
21	Teknik ashensori		
22	Instalime elektrike		
23	Punues duralumini		
24	Instalues dhe Riparues të Sistemeve Ngrohëse dhe Ftohëse		
25	Kurse të tjera që mund të ofroni (në kuadër të formimit profesional) Specialist rrjeteash Kompjuterike		

Për ofrimin e këtyre kurseve dhe trajnimeve profesionale, Qendra Shqiptare per Popullsin dhe Zhvillimin, dega e saj Qendra Aulona Vlore, fton të gjitha Qendrat e Formimit Profesional privat kompanitë që kanë licensë për ofrimin e këtyre produkteve, që të paraqesin interesin e tyre brenda datës 06.11.2020 **ora 16:30** me E-mail (info@acpd.org.al) ose me postë në adresën (adresa: L. 29 Nentori, Rr. Dede A. Amataj, Cerdhja 15, kati dyte, Vlore, Shqiperi, tel: 033 224 531 , duke paraqitur ofertat financiare dhe dokumentat plotësuese.

MËNYRA E PJESËMARRJES NË TENDER

Kompanitë/Subjektet që ofrojnë kurse profesionale duhet të dorëzojnë ofertat e tyre financiare duke përfshirë edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kopje e NIPT-it dhe ekstrakt i QKR (ky dokument duhet të jete leshuar jo me pare se nje muaj).
- Ofertën Financiare e cila duhet të përfshijë çmimet në lek dhe përfshire TVSH. Ju lutemi, përdorni tabelën bashkangjitur kësaj Ftese për Shprehje Interesi.
- Jepni një përshkrim të shkurtër të kompanisë / institucionit tuaj, listë të kurseve /trajnimeve të ofruara, certifikime të cilat keni / posedon kompania juaj, si dhe përvoja dhe kualifikimi i kompanisë / subjektit, për shërbime të ofrimit të kurseve /trajnimeve.

- Informacion të dy-tre vitet e fundit të numrit të kursantëve që keni patur në secilin kurs. Numrin dhe informacione të tjera që provojnë se sa prej tyre janë punësuar pas përfundimit të kurseve të formimit profesional.
- Një program të kursit, kohëzgjatjes së kursit, çmimit për çdo kurs në raport me kohëzgjatjen e tij, si dhe disponueshmëritë e tyre (sa shpejt mund të fillojë një kurs, cili është numri minimal i pjesëmarrësve për të filluar një kurs etj).

Ofertuesit duhen të ofrojnë informacionin e mëposhtëm shtesë:

- Numri i ofertës,
- Data e ofertës,
- Vlefshmëria e ofertës. (Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 2 vite),
- Programin dhe kurrikulën e detajuar të kurseve / trajnimeve të formimit profesional.
- Oferta financiare duhet të përfshijë TVSH-në.

Kushtet dhe Rregullat e Ofertimit

- Ofertimet do të vlerësohen për çdo kurs më vete.

Jeni të ftuar të dorëzoni ofertën tuaj nëpërmjet emailit zyrtar E-mail (info@acpd.org.al) ose me postë në adresën (adresa: L. 29 Nentori, Rr. Dede A. Amataj, Cerdhja 15, kati dyte, Vlore, Shqiperi, tel: 033 224 531 , brenda datës 06.11.2020 **ora 16:30**).

Forma e komunikimit në rast se keni pyetje duhet të jetë me shkrim, nëpërmjet formës elektronike email info@acpd.org.al

Përgjigjiet do ti merrni gjithashtu nëpërmjet formës elektronike info@acpd.org.al

Oferta duhet të jetë e vlefshme për minimumi 2- vjet.

Vlerësimi i ofertave:

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për plotësimin e dokumentacionit dhe oferten financiare.

Qendra Shqiptare per Popullsin dhe Zhvillimin nuk është përgjegjës për ndonjë kosto që lidhet me përgatitjen e Furnizuesit dhe paraqitjen e ofertës.

Qendra Shqiptare per Popullsin dhe Zhvillimin inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesi.